



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3.4.2023

Nr: 245

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E LISTËS SHUMEMËRORE TË KËSHILLIT BASHKIAK,
BASHKIA LEZHË, TË SUBJEKTIT ZGJEDHOR "PARTIA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
EMIGRANTËVE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023**

Sot, më datë 3.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën:

- KËRKUES:** "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve" me shkronja nistore "P.M.D.E"
- OBJEKTI:** Miratimi i listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Lezhë, të subjektit zgjedhor "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
- BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenet 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023 "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 5, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Presidenti i Republikës me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Data: 3.4.2023 Nr: 245
Ora: 16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumëmemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Lezhë, të subjektit zgjedhor "Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve" për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Me vendimin nr. 105, datë 8.3.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbështetje të neneve 67 dhe 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionin për miratimin e listës shumemërore.

Në mbështetje të nenit 73 të Kodit Zgjedhor, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikoi listën shumemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Lezhë të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” dhe dokumentacionin përkatës ligjor të paraqitur, dhe konstatoi se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga nenet 67 dhe 72 të Kodit Zgjedhor.

Në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik.

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak rezulton se, të gjithë kandidatët e listës shumemërore nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet postës elektronike ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me anë të komunikimit elektronik në datën 29.3.2023 ka dërguar verifikimin e të dhënave për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, dhe përkatësisht për Bashkinë Lezhë të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” sipas së cilës rezulton se:

1. Kandidatët e propozuar në listën shumemërore nga “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” për këshillin bashkiak **Lezhë** (sipas lidhjes nr. 1), nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015. Rezultojnë të jenë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, për Bashkinë Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”. Referuar ligjit, nr. 138/2015

Data: 3.4.2023 Nr: 245
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e listës shumemërore të këshillit bashkiak, Bashkia Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose shtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve” nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e kandidatëve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Pas verifikimeve përkatëse të kërkesës dhe dokumentacionit në tërësi të listës shumëmemërore të subjektit zgjedhor, “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, konstatoj se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 67, 72 dhe 73 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenet 67, 72 dhe 73, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 18.1.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe në nenin 5, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak, në Bashkinë Lezhë, të subjektit zgjedhor “Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve**Bashkia Lezhë****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
1	Kristjan	Shkurt	Leka	14/11/1991	M
2	Jorina	Shkurt	Pergjergji	31/10/1988	F
3	Besnik	Frrok	Çuni	09/05/1985	M
4	Mimoza	Zef	Ndoj	10/09/1990	F
5	Ardit	Shkurt	Leka	03/03/1986	M
6	Yllka	Shkurt	Leka	12/09/1983	F
7	Bledar	Skander	Prenga	28/04/1980	M
8	Ankeleta	Armira	Leka	02/12/1996	F
9	Vitor	Dodë	Marku	15/04/1992	M
10	Denisa	Gjovalin	Daija	28/04/1998	F
11	Ardit	Aleksander	Daija	19/04/1988	M
12	Santina	Gjovalin	Gjoka	08/03/2004	F
13	Zef	Lazër	Zefi	14/05/1976	M
14	Stela	Gjergj	Pepa	13/08/1999	F
15	Daniel	Armira	Deda	24/01/2002	M
16	Mimoza	Gjin	Doçaj	18/12/1991	F
17	Arjan	Pjetër	Pepa	28/01/1986	M
18	Vitore	Llesh	Deda	14/07/1970	F
19	Gjovalin	Dodë	Marku	13/04/1996	M
20	Kristjana	Prend	Pergjergji	27/07/1993	F
21	Ilir	Zef	Pepa	10/09/1983	M
22	Vangjeli	Vasil	Daija	24/03/1959	F
23	Orlando	Armira	Deda	01/06/2000	M
24	Drane	Gegë	Leka	25/06/1955	F
25	Pashk	Frrok	Çuni	20/03/1992	M
26	Valentina	Gjon	Marku	10/05/1967	F
27	Armira	Pjetër	Deda	21/03/1973	M
28	Ermira	Pjetër	Gjoka	22/06/1977	F
29	Agustin	Zef	Lleshi	28/10/1983	M
30	Lorna	Gani	Lala	21/01/1991	F
31	Viktor	Ndoc	Gjoni	14/03/1978	M
32	Donika	Fran	Gjoni	02/08/1988	F
33	Gaspar	Lin	Tusha	02/03/1992	M
34	Elona	Preng	Tusha	16/10/1993	F
35	Dorian	Kol	Gega	11/04/1981	M
36	Lize	Llesh	Matrizi	25/03/1995	F



Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve**Bashkia Lezhë****Lista shumemërore për kandidatët për këshillin bashkiak**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
37	Lulzim	Gjon	Paloka	03/11/1987	M
38	Marë	Pjetër	Fusha	11/01/1965	F
39	Gentian	Pashk	Leka	06/01/1991	M
40	Albana	Mark	Gjoka	03/04/1981	F
41	Xhovalin	Simon	Pjetri	19/02/1988	M
42	Sara	Gjet	Prenga	17/03/1998	F

Kjo listë mbyllet me numrin rendor**42**